



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të neneve 12 dhe 28 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 6 nënparagrafi 1.7 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe neneve 16 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, 2023 të miratojë këtë :

### **PROPOZIM**

#### **VENDIM**

#### **PËR MIRATIMIN E NISMËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR HYRJE NË BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL**

##### **Neni 1**

I. **MIRATOHET**, Nisma e Kryetarit të Komunës së Lipjanit , Nr.020/01-17913 e datës 12.04.2023, për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal.

II. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunat si në vijim:

- 2.1 Komunës së Lipjanit
- 2.2 Komunës së Prishtinës –Kryeqytetit të Kosovës
- 2.3 Komunës së Podujevës
- 2.4 Komunës së Fushë Kosovës
- 2.5 Komunës së Obiliqit, dhe
- 2.6 Komunës së Graçanicës

III. Autorizohet Kryetari i Komunës për të filluar konsultimet me komunat për përgaditjen e Propozim –Marrëveshjes për bashkëpunimin ndërkomunal.

IV. Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

### Arsyetim

Baza ligjore për të miratuar këtë Propozim- Vendim është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12 dhe 28 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 7 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 6 nënparagrafi 1.7 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe neneve 16 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Inicimi i bashkëpunimit ndërkomunal është filluar nga Kryetari i Komunës së Prishtinës-Kryeqytetit të Kosovës i përkrahur edhe nga Kryetarët e të gjitha komunave të cekura në dispozitiv të këtij Propozim- Vendimi. Kryeqyteti dhe pjesa dërmuese e këtyre komunave tashmë kanë miratuar nismat në kuvendet e tyre komunale me qëllim të realizimit të interesave të të përbashkëta nga fusha e shërbimeve publike komunale dhe zhvillimit lokal .

Nga të cekurat më lartë kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/01-18481  
Lipjan, Më 13.04.2023

KRYETARI I KOMUNES  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 , nenit 6 paragrafi 2.1 i Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal nr.04/L-010 , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.07/2011 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës paraqet këtë kërkesë për miratim:

### PROPOZIM NISMË PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMUNAL

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet Komunave si në vijim:

- 1.1 Komunës së Lipjanit
- 1.2 Komunës së Prishtinës –Kryeqytetit të Kosovës
- 1.3 Komunës së Podujevës
- 1.4 Komunës së Fushë Kosovës
- 1.5 Komunës së Obiliqit, dhe
- 1.6 Komunës së Graçanicës

2. Sipas pikës 1 të këtij propozimi, bashkëpunimi ndërkomunal ka për qëllim ushtrimin më efikas dhe efektiv të kompetencave vetanake dhe realizimin e interesave dhe qëllimeve të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike dhe të zhvillimit lokal.

3. Bashkëngjitur me propozimin për nismë, gjeni propozim vendimin për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës.

1Nr. 020/01-17913  
Lipjan, 12.04.2023

KRYETARI I KOMUNES

Imri Ahmeti

